

BILANCI I PAGESAVE¹

Përmbajtja

Llogaria korrente	2
Tregtia e mallrave	3
Tregtia e shërbimeve	3
Të ardhurat dytësore	4
Të ardhurat dytësore	5
Llogaria kapitale	5
Llogaria financiare	5

Kryesore:

Në tremujorin e parë të vitit 2025:

- Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 212 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë;
- Llogaria e shërbimeve vlerësohet në një balancë pozitive prej rreth 696 milionë euro, me rritje në terma vjetorë;
- Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 362 milionë euro, në rritje vjetore me 2%;
- Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 251 milionë euro;
- Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 7.5 muaj importe në mallra dhe shërbime.

Në tremujorin e parë të vitit 2025, *bilanci i përgjithshëm i pagesave* rezultoi pozitiv, në rritje të mjeteve të rezervës valutore, rreth 576 milionë euro.

Deficiti i llogarisë korrente shënon 212 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 145 milionë euro (ose 41%), në sfondin e përmirësimit të bilancit tregtar në *mallra* e *shërbime*.

Zgjerimi i eksportit në “*produkte minerale*” dhe rënia e konsiderueshme e importit në “*mjetet e transportit*” diktuan ecurinë pozitive të deficitit tregtar në mallra. Në të njëjtën kohë, suficiti tregtar në *shërbime* u zgjerua ndjeshëm në kategoritë *shërbime udhëtimi*, *shërbime të tjera biznesi* dhe në të ardhurat neto nga *shërbime për përpunim të inputeve fizike*. Të ardhurat nga emigrantët kanë qenë përcaktuesit e flukseve hyrëse të të ardhurave dytësore. Ndërkohë, të ardhurat parësore kanë njohur zgjerim si në flukse hyrëse në formën e të ardhurave nga puna, ashtu edhe në ato dalëse në formën e *kthimit nga investimet*.

Llogaria kapitale u mbyll me një fluks neto negativ prej 34 milionë euro, kundrejt atij prej 75 milionë euro, në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar. Tremujori ka evidentuar zgjerim të flukseve hyrëse drejt sektorit privat.

Shkalla e ekspozimit² të ekonomisë shqiptare vlerësohet në -246 milionë euro kundrejt nivelit prej -432 milionë euro, në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar.

Flukset hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare (përfshirë mjetet e rezervës) shënojnë 293 milionë euro dhe mundësojnë plotësisht mbulimin e deficitit korrent.

Në një total prej rreth 903 milionë euro (pa përfshirë mjetet e rezervës) flukset neto-hyrëse në llogarinë financiare, reflektojnë zgjerimin e detyrimeve neto në formën e *investimeve të portofolit* (558 milionë euro), - në vijim të emetimit të Eurobondit të Qeverisë së Përgjithshme (në vlerë emërore prej 650 milionë euro), *investimeve direkte* (295 milionë euro) dhe *investimeve të tjera* (50 milionë euro).

Rezerva valutore, në fund të marsit 2025, shënon 6,824 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 7.5 muaj importe mesatare vjetore në *mallra dhe shërbime* dhe rreth 531% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.



Grafik 1. Llogaria korrente dhe flukset financiare neto (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).
Shënim: Flukset financiare neto paraqiten sipas parimit të drejtimit të investimit.

- Të dhënat janë hartuar bazuar në metodologjinë e FMN “Manuali i Bilancit të Pagesave, Botimi i 6-të”. Bilanci i Pagesave (BP) regjistron të gjitha transaksionet ekonomike të ndodhura midis njësisë rezidente dhe jorezidente, gjatë një periudhe të dhënë kohe.
- Bilanci i llogarisë korrente së bashku me bilancin e llogarisë kapitale përcakton shkallën e ekspozimit të ekonomisë shqiptare me pjesën tjetër të botës, ndërsa llogaria financiare shpjegon si është financuar ky ekspozim.

LLOGARIA KORRENTE

Gjatë tremujorit të parë 2025, transaksionet korrente u zgjeruan me rreth 8% në terma vjetorë, në një nivel prej rreth 5,387 milionë euro. Deficiti i *llogarisë korrente* vlerësohet në 212 milionë euro, i ngushtuar me rreth 145 milionë euro në terma vjetorë.

Përmirësimi i *llogarisë korrente* u ndikua nga ngushtimi i deficitit tregtar në mallra e shërbime. Në të njëjtën kohë, zbutje të deficitit korrent dhanë edhe zgjerimi i bilancit pozitiv në të ardhura dytësore, sëbashku me tkurrjen e bilancit negativ në të ardhura parësore.

Deficiti tregtar në mallra u ngushtua me rreth 68 milionë euro në terma vjetorë dhe reflektonte kryesisht përmirësimin e bilancit tregtar në “produkte minerale”, diktuar nga zgjerimi i eksporteve në “produkte minerale”.

Në terma vjetorë, *suficiti tregtar në shërbime* u zgjerua me 11% në nivelin 696 milionë euro, ku shërbimet e udhëtimit, shërbimet e tjera biznesi dhe shërbimet për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët⁶ zgjeruan balancat e tyre pozitive.

Të ardhurat parësore (puna dhe kapitali) rezultojnë në balancë negative prej rreth -40 milionë euro, kundrejt -47 milionë euro në një vit më parë. Flukset neto hyrëse të të ardhurave nga puna janë zgjeruar me +17 milionë euro në nivelin 144 milionë euro, ndërkohë, të ardhurat nga investimi (kthimit nga kapitali) zgjeruan balancën negative me rreth 10 milionë euro, në nivelin 183 milionë euro.

Gjatë periudhës, rreth 88% e shpenzimeve korrente³ kanë shkuar për financimin e importit të mallrave dhe shërbimeve. Ndërkohë, hyrjet valutore⁴ janë siguruar kryesisht nga eksporti i shërbimeve (në masën 58%), si dhe nga eksporti i mallrave dhe transfertave të njëanshme drejt sektorit privat (sëbashku në rreth 33%).

Në tremujorin e parë 2025, përmirësimi i deficitit korrent është ndikuar kryesisht nga ngushtimi i deficitit tregtar në mallra e shërbime

	Të dhëna kumulative (4-mujore) për fundin e periudhës, në milionë euro							
	T1 2024			T1 2025			T1 2024	T1 2025
	Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Bilanci
Llogaria korrente	477	10,730	11,207	462	11,825	12,287	357.5	212.1
<i>në përqindje ndaj PBB</i>	-2%	47%	49%	-2%	46%	48%		
Mallra	4,885	1,739	6,624	5,525	1,792	7,317	1,236	1,168
Shërbime	3,439	6,755	3,316	3,942	7,543	3,601	629	696
Shërbime për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët	764	765	1	671	671	1	190	199
Transport	330	727	397	434	803	368	60	68
Udhëtime	1,916	4,338	2,422	2,320	5,078	2,758	267	295
Shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni	92	205	114	115	223	108	25	21
Shërbime të tjera biznesi	409	551	142	493	624	131	111	135
Shërbime dhe mallra qeveritare	3	42	44	6	51	57	7	2
Shërbime të tjera	70	127	197	84	93	177	18	21
Të ardhura parësore	253	834	1,087	184	969	1,153	47	40
Të ardhura nga puna	562	599	37	641	682	42	127	144
Të ardhura nga investimet	815	226	1,041	826	276	1,102	174	183
Investime direkte	786	71	857	806	80	886	182	199
Investime portofoli	26	65	39	11	74	64	23	18
Investime të tjera	128	17	145	135	17	152	37	35
Mjetet e rezervës	73	73		104	104		22	33
Të ardhura të tjera parësore	0	10	9	1	10	9	0	0
Të ardhura dytësore	1,223	1,403	180	1,305	1,522	216	297	301
Të ardhura nga emigrantët	956	956	-	1,054	1,054	-	242	251

Tabela. Ecuria e përbërësve të bilancit të pagesave (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

³ Shpenzimet korrente përfshijnë importin e mallrave, importin e shërbimeve, daljet në të ardhurat dytësore dhe daljet në të ardhurat dytësore.


⁴ Hyrjet valutore përfshijnë eksportin e mallrave, eksportin e shërbimeve, hyrjet në të ardhurat dytësore dhe hyrjet në të ardhurat dytësore.



TREGTIA E MALLRAVE

Vëllimi i përgjithshëm i tregtisë në mallra u zgjerua me 8% në terma vjetorë, në nivelin 2,174 milionë euro. Tregtia në mallra përfaqëson rreth 40% të transaksioneve korrente. Eksporti i mallrave u zgjerua me 29% në terma vjetorë, duke shënuar 503 milionë euro. Rritje e konsiderueshme është vërejtur në eksportet e “produkte minerale — energji elektrike dhe lëndë djegëse. Ndërkohë, eksportet në “metale bazë” kanë regjistruar rënie. Importi i mallrave është zgjeruar lehtësisht me 3% në terma vjetorë dhe shënon 1,671 milionë euro. Rritjen më të madhe e shënuan importet në grupmallrat “produkte minerale”, dhe “ushqime, pije alkolike, duhan”, duke reflektuar rritjen e përgjithshme të konsumit të familjeve e aktivitetit turistik.

Deficiti tregtar në mallra shënon 1,168 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me 5%. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet vlerësohet në nivelin 30% nga 24% në një vit më parë.



Grafik 2. Ecuria e tregtisë në mallra (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Deficiti i tregtisë në mallra u ngushtua me 68 milionë euro dhe shënon 1,168 milionë euro

TREGTIA E SHËRBIMEVE

Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve u mbyll me një balancë pozitive, prej rreth 696 milionë euro, e zgjeruar në terma vjetorë me rreth 11%. Kjo ecuri u diktua nga zgjerimi i të ardhurave neto në kategorinë shërbime udhëtimi, në reflektim të rritjes së numrit të udhëtarëve të huaj në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, shërbimet e biznesit dhe ato për përpunim të inputeve të zotëruara nga të tjerët kanë vijuar zgjerimin e balancave pozitive.

Shërbimet e udhëtimit kanë zgjeruar balancën pozitive në +295 milionë euro, kundrejt nivelit +267 milionë euro, në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga shërbimet e udhëtimit u rritën në të njëjtën masë me rreth 11% në terma vjetorë. Rritja e numrit të udhëtarëve përbën faktorin përcaktues për këtë ecuri. Në të njëjtën kohë, shpenzimi ditor ka shënuar rritje.

Për tremujorin e parë 2025, eksporti i shërbimeve të udhëtimit i ka siguruar ekonomisë vendase rreth 874 milionë euro. Nga ana tjetër, udhëtarët rezidentë (shqiptarë dhe të huaj) kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë vendit 579 milionë euro.

Shërbimet e udhëtimit gjenerojnë respektivisht 58% të flukseve valutore në hyrje dhe rreth 72% të shpenzimeve të kategorisë së shërbimeve.



Shërbime të tjera biznesi rezultuan në bilanc pozitiv prej rreth 135 milionë euro, në rritje vjetore prej 21%. Për tremujorin e parë të vitit, flukset valutore hyrëse për ekonominë shqiptarë nën këtë kategori shërbimi, shënuan rreth 171 milionë euro.

Bilanci pozitiv i shërbimeve për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët⁵ u vlerësua në 199 milionë euro. Flukset valutore hyrëse të kësaj kategorie u rritën në terma vjetorë me 5%, në nivelin 199 milionë euro dhe përfaqësojnë shërbime që ekonomia shqiptare i ofron partnerëve të huaj (jorezidentëve) për përpunimin e mallrave të zotëruara prej këtyre të fundit.


TË ARDHURAT PARËSORE

Llogaria e të ardhurave parësore (puna dhe kapitali) u mbyll me balancë negative prej 40 milionë euro, nga -47 milionë euro në të njëjtën periudhë një vit më parë. Kjo ecuri u ndikua kryesisht nga zgjerimi i të hyrave neto nga puna (kompensimi i punonjësve).

Të ardhurat neto nga puna, të cilat kryesojnë flukset hyrëse të të ardhurave parësore, rezultuan në një fluks neto pozitiv prej 144 milionë euro ose 13% më shumë se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Rritja i dedikohet, në masën më të madhe, rritjes së numrit të punonjësve sezonalë dhe kufitarë jashtë vendit.

Të ardhurat neto nga investimet thelluan balancën negative, në nivelin -183 milionë euro nga -174 milionë euro, në tremujorin e parë të 2024. Flukset valutore neto nga investimi, në masë më të madhe, janë në formën e flukseve dalëse të “fitimit të riinvestuar”⁶. Këto të fundit, u rritën lehtësisht në 214 milionë euro nga 212 milionë euro, në një vit më parë.

Ndërkohë, pagesat e interesave për huatë shënuan 40 milionë euro nga 41 milionë një vit më parë.



Grafik 3. Ecuria e të ardhurave parësore nga investimet (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

⁵ Këtu përfshihet vëllimi i transaksioneve të kryera nga industria e përpunimit me lëndë të dytë të huaj në vend.

⁶ Konform standardit metodologjik—parimit të regjistrimit të dyfishtë të transaksionit, zëri “fitim i riinvestuar”, si komponent i investimeve direkte në llogarinë financiare, duhet të regjistrohet edhe në llogarinë e të ardhurave dytësore nga investimet. Ky regjistrim kryhet në masë të njëjtë, por në kahe të kundërta.


Rritja e numrit të punonjësve sezonalë dhe kufitarë jashtë vendit ka zgjeruar të ardhurat parësore nga puna



TË ARDHURAT DYTËSORE

Të ardhurat dytësore u vlerësuan në 301 milionë euro. Rreth 83% e të ardhurave dytësore përfaqësohet nga “të ardhurat nga emigrantët”.

Prurjet valutore të emigrantëve, shënuan rreth 251 milionë euro, në rritje vjetore (4%). Gjatë periudhës është vërejtur zgjerim jo vetëm në volumin e dërgesave përmes kanaleve formale (sistem bankar), por edhe prurjeve në cash.



Grafik 4. Ecuria e të ardhurave dytësore dhe të ardhurat nga emigrantët (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

LLOGARIA KAPITALE

Llogaria kapitale u mbyll me një fluks neto negativ prej 34 milionë euro, kundrejt atij prej 75 milionë euro në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar. Tremujori ka evidentuar zgjerim të flukseve hyrëse drejt sektorit privat.

LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) rezultoi në një fluks neto hyrës prej rreth 903 milionë euro, krahasimisht me fluksin hyrës prej 137 milionë euro, të regjistruara në të njëjtën periudhë në 2024.

Flukset hyrëse (neto) në llogarinë financiare, reflektojnë zgjerimin e detyrimeve neto në formën e investimeve të portofolit (558 milionë euro), investimeve direkte (295 milionë euro) dhe investimeve të tjera (50 milionë euro).

Fluksi hyrës nga investimet e huaja direkte shënon 362 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë me 2%. Injektimi me kapital të ri dhe riinvestimi u zgjeruan me 8 milionë euro në terma vjetorë, në nivelin 361 milionë euro.


Më tej, marrëdhëniet e borxhit mes kompanive të lidhura nën një marrëdhënie të investimit direkt, rezultuan me një fluks hyrës, prej 1.5 milionë euro, pa lëvizje të konsiderueshme nga niveli i regjistruar në një vit më parë (1.2 milionë euro).

Për tremujorin e parë të vitit 2025, prurjet valutore nga emigrantët vlerësohen në rreth 251 milionë euro




Gjatë tremujorit të parë 2025, flukset valutore hyrëse në formën e *investimeve të huaja direkte* ishin të përqendruara kryesisht në pasuri të paluajtshme (në masën 27%), sektorin e ndërmjetësimit financiar (në masën 21%), hidrokarbureve (në masën 14%), energjitikës (në masën 6%), si dhe komunikacionit (në masën 4%).

Në të njëjtën kohë, zotërimet tona jashtë - mjetet financiare në formën e *investimeve direkte jashtë* vlerësohen në rreth 67 milionë euro, në rënie me rreth 7%.



Grafik 5. Llogaria financiare dhe flukset neto sipas kategorive përbërëse (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)



Grafik 6. Ecuria e fluksit të investimeve direkte - mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

Investimet e portofolit rezultuan në fluks neto hyrës prej 558 milionë euro. Në muajin shkurt të 2025, u emetua Eurobondi i *Qeverisë së Përgjithshme* (në vlerë emërore 650 milionë euro), duke çuar në zgjerim të detyrimeve të ekonomisë shqiptare ndaj jorezidentëve në formën e investimeve në letra me vlerë të borxhit (flukse neto +514 milionë euro). Në të njëjtën kohë, korporatat depozituese (bankat) kanë terhequr flukset valutore të investuara jashtë në letra me vlerë të borxhit, duke sjellë rënie të zotërimeve të ekonomisë shqiptare në tituj borxhi (në rreth -32 milionë euro).


Llogaria *investimet e tjera* u mbyll në fluks neto hyrës prej 50 milionë euro, ku zhvillimet kryesore lidhen me *Sektorin e Korporatave Depozituese*.

Në kahun e zotërimeve tona jashtë, *Spektori i Korporatave Depozituese* ka zgjeruar portofolin e huasë me 102 milionë euro, duke ulur njëkohësisht zotërimet në “*monedha dhe depozita*” më rreth 99 milionë euro. Ndërkohë, *Spektori i Tjerë* kanë zgjeruar detyrimet për “*kredi tregtare dhe paradhënie*”, në rreth 56 milionë euro.

Në kahun e detyrimeve, teprica e depozitave të jorezidentëve në ekonominë shqiptare është zgjeruar me rreth 91 milionë euro. Në të njëjtën kohë, detyrimet në formën e huasë të *Qeverisë së Përgjithshme* rezultuan në fluks neto dalës në rreth 51 milionë euro, si rezultat i niveleve më të larta të shlyerjes së borxhit përkundrejt flukseve të reja në huamarrje. *Spektori i Tjerë* kanë rritur detyrimet e tyre në “*kredi tregtare dhe paradhënie*”, me rreth 49 milionë euro.

Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 362 milionë euro, me rritje rreth 2% në terma vjetorë





Grafik 7. Ecuria e fluksit të investimeve të portofolit dhe investimeve të tjera – mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Gjatë tremujorit të parë 2025, *mjetet e rezervës* u zgjeruan me 576 milionë euro, ndikuar kryesisht nga hyrjet në kuadër të emetimit të Eurobondit qeveritar.

Në fund të periudhës, *rezerva valutore* shënon 6,824 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 7.5 muaj importe mesatare vjetore në *mallra dhe shërbime*.

*Rezerva valutore
vlerësohet mjaftueshëm
për mbulimin e 7.5
muaj importe mesatare
vjetore në mallra e
shërbime*



**DEPARTAMENTI I
STATISTIKAVE
FINANCIARE**

Selia Qendrore Nr. 1 e Bankës së
Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1,
Tiranë

Tel: +355 4 241 93 01
+355 4 241 93 02
+355 4 241 93 03
+355 4 241 94 09
+355 4 241 94 10
+355 4 241 94 11

Fax: +355 4 241 94 08
Email: statistics@bankofalbania.org



Shënime:

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në rastin e rishikimeve që sjellin ndryshime të treguesve, Banka e Shqipërisë njeh përdoruesit me faktorët e rishikimit dhe ndikimin përkatës.

Gjatë periudhës nuk kanë ndodhur ndryshime në bilancin e pagesave.

Për më shumë informacion mbi të dhënat e bilancit të pagesave referojuni linkut të mëposhtëm:

[https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/
Bilanci_i_Pagesave/Te_dhenat_kryesore_per_Bilancin_e_Pagesave.html](https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Bilanci_i_Pagesave/Te_dhenat_kryesore_per_Bilancin_e_Pagesave.html)